



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Legjislatura III**

Komisioni për Punë të Brendshme dhe Siguri  
Mbledhja nr. 54  
Prishtinë, më 11 tetor 2010  
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225  
Mbledhja filloi në orën 10:00

**P R O C E S V E R B A L**

**I mbledhjes së Komisionit për Punë të Brendshme dhe Siguri**

**Morën pjesë:** Rustem Mustafa, Shkumbin Demaliaj, Basri Musmurati, Ismet Beqiri,  
Lulzim Zeneli dhe Zylfi Merxha - anëtarë të Komisionit.

**Munguan:** Suzana Novoberdaliu, Eqrem Kryeziu dhe Radmila Vujoviq - anëtarë të Komisionit.

**Nga Zyra Mbështetëse morën pjesë:** Antigona Ibraj, Blerina Pula, Afrim Hoti dhe Nuredin Ibishi.

**Mbledhjen e kryesoi:** Rustem Mustafa, kryetar i Komisionit.

**Rendi i ditës:**

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më **27.09.2010**,
3. Miratimi i raportit përfundimtar i Projektligjit për Inspektoratin Policor të Kosovës,
4. Të ndryshme.

**Kryetari** konstatoi se janë plotësuar kushtet dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

### **1. Miratimi i rendit të ditës**

*Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.*

### **2. Miratimi i procesverbalit të 27.09.2010**

*Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 27.09.2010 u miratua pa vërejtje.*

### **3. Miratimi i raportit përfundimtar i Projektligjit për Inspektoratin Policor të Kosovës**

**Kryetari i Komisionit** – Sa i përket Projektligjit për Inspektoratin Policor, si referues është caktuar deputeti Shkumbin Demaliaj, të cilit ia jap fjalën për ta paraqitur para Komisionit Raportin me propozimamendamente.

**Shkumbin Demaliaj**- Kjo është e vetmja pikë e rendit të ditës, që sot na ka mbledhur në këtë mbledhje. Në mënyrë të përshpejtuar kemi ardhur te përfundimi i amendamentimit të këtij projektligji. Pas fillimit të punës kemi organizuar një grup punues së bashku me ICITAP, EULEX, OSBE, sponzorizuesin, si dhe të gjithë mekanizmat e tjerë. Kemi ardhur në përfundim që t'i paraqesim këto amendamente për miratim në Komision. Nëse ka dikush ndonjë vërejtje në këto amendamente le t'i paraqes sot, këtu në mbledhje, në mënyrë që teksti të jetë sa më i kompletuar për lexim të dytë.

**Kryetari i Komisionit** – Unë personalisht kam punuar mjaft me referuesin e Projektligjit, por edhe me ju si deputet dhe mendoj se idenë e këtij Ligji e dimë. Nëse ka dikush ndonjë vërejtje le të urdhërojë, nëse jo, ju ftoj që t'i miratojmë amendamentet e propozuara të Projektligjit për Inspektoratin Policor të Kosovës.

*Anëtarët e Komisionit e miratuan raportin me amendamente për Projektligjin për Inspektoratin Policor të Kosovës.*

### **4. Të ndryshme**

**Kryetari i Komisionit** – Projektligji për gjendjen civile ka ardhur për shqyrtim në Kuvend, por ende nuk është miratuar në lexim të parë. Ky projektligj bie në fushën e komisionit tonë. Projektligj rregullon kuptimin dhe përbërësit e gjendjes civile të shtetasve të Kosovës, shtetasve të huaj dhe të personave pa shtetësi me banim të përkohshëm ose të përhershëm në Republikën e Kosovës, përcaktimin e rregullave për krijimin, ruajtjen dhe ndryshimin e tyre, si dhe organizimin dhe funksionimin e shërbimit të gjendjes civile në Republikën e Kosovës. Drafti i këtij ligji është i mirë dhe unë propozoj që ta përkrahim dhe ta miratojmë në leximin e parë.

*Anëtarët e Komisionit u pajtuan që Projektligji për gjendjen civile të miratohet në parim.*

**Kryetari i Komisionit** – Komisioni jonë në bashkëpunim me DCAF- in dhe OSBE- në nesër ka organizuar një punëtori, ku do të shqyrtohet Projektligji për shërbimet e sigurisë private, referues i së cilit është deputeti Lulzim Zeneli. Në këtë punëtori do të marrim pjesë ne, si Komision dhe sponsorizuesi, si dhe janë të ftuar 4 ekspertë të huaj për shqyrtimin e këtij projektligji. Është me interes që edhe anëtarë të tjerë të Komisionit të jenë pjesë e kësaj punëtorie, sepse siç e dini ky projektligj i është kthyer sponsorizuesit dy herë dhe është me rëndësi të përfundohet sa më shpejt.

Pasi nuk kishte pika të tjera për diskutim, kryetari i Komisionit e mbylli takimin.

Mbledhja përfundoi në orën 11:00.

E hartoi:

Njësia Mbështetëse e Komisionit

Kryetari i Komisionit

---

Rrustem Mustafa